

Nr. 758 Prot



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

URDHËR

Nr. 27 datë 18 / 01 / 2021

PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË SË TRANSFORMIMIT TË SKEMËS SË
MBËSHTETJES FEED IN TARIFF NË KONTRATË PËR DIFERENCË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të Ligjit Nr. 43 datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, të Ligjit Nr. 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 742, datë 12.12.2018 "Për miratimin e planit strategjik për reformimin e sektorit të energjisë në Shqipëri",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Strategjisë së transformimit të skemës së mbështetjes Feed in Tariff në Kontratë për diferencë sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij urdhri.
2. Ngarkohen strukturat përkatëse në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enti Rregullator i Energjisë, OST sh.a, OSHEE Group sh.a, KESH sh.a dhe ALPEX sh.a, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI


Belinda Balluku



Transformimi i skemës së mbështetjes “Feed In Tariff” në Kontratë për Diferencë

Ky dokument prezanton strategjinë e transformimit të skemës ekzistuese të mbështetjes për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme me “Feed In Tariff” (FiT), në një skemë mbështetëse me bazë konkurruese të mundësuar nëpërmjet sistemit të Kontratës për Diferencë (KpD). Qëllimi i këtij dokumenti është të paraqesë në një mënyrë lehtësisht të kuptueshme skemën e mbështetjes me anë të Kontratës për Diferencë (KpD) dhe Operatorit të Energjive të Rinovueshme (OER) që e shoqëron atë.

Ky dokument përmban kapitujt më poshtë:

- 1- Prezantimi i situatës aktuale
- 2- Përshkrimi i ndryshimeve më të rëndësishme që rrjedhin nga Vendimi i Këshillit të Ministrave për krijimin e OER.
- 3- Vlerësimi i kostove që shoqëron procesin.
- 4- Prezantimi i masave të cilat po ndërmerren për të zbatuar me efikasitet skemën e Kontratës për Diferencë
- 5- Një përshkrim gjithëpërfshirës të kuadrit ligjor mbështetës në funksion të promovimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme

1. Hyrje

1.1. Përmbledhje e situatës aktuale

Situata aktuale e politikave në lidhje me skemat e mbështetjes për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme përbëhet nga ligji Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit energjisë nga burime të rinovueshme” dhe disa vendimeve të ndërmarra përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ligji nr. 7/2017 përmban elementët e mëposhtëm në lidhje me skemat e mbështetjes për prodhimin e energjisë elektrike nga këto burime:

Neni	Elementet kryesore
Neni 9 – Kontratat për diferencë	Ligji përcakton një skemë mbështetje nëpërmjet Kontratës për diferencë e cila llogaritet si diferenca midis çmimit me të cilin prodhuesi i energjisë së rinovueshme është shpallur fitues në procesin konkurrues për dhënien e ndihmës (çmimi i caktuar) dhe çmimit të tregut të energjisë elektrike (çmimi reference). Skema KpD zhvillohet nëpërmjet një procesi ankandi konkurrues.
Neni 10 – Masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme.	Prodhuesit e vegjël janë të përjashtuar nga skema KpD. Kjo përfshin prodhuesit e energjive të rinovueshme (kryesisht hidrik dhe fotovoltaike) sipas përcaktimeve në ligjin e energjive të rinovueshme. Tarifa Feed In përllogaritet përmes Metodologjisë për përcaktimin e Çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga çdo prodhues tjetër me përparësi, sipas nje vendimi të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur dhe miratohet nga ERE. Për impiantet hidrike, nën 2MW, Metodologjia përcakton nje çmim blerjeje të energjisë elektrike dhe kufizohet nga një çmim minimal i cili korrespondon me çmimin e miratuar nga ERE për vitin 2016.

Neni 15 – Skemat e matjes neto të energjisë	Një skemë e matjes neto është e përcaktuar për energjinë nga era dhe dielli për sistemet deri në 500 kW.
Neni 22 - Trajtimi i prodhuesve ekzistues me përparësi	Prodhuesit me përparësi, të cilët kanë marrë certifikatën e pranimit të veprës të centralit elektrik, brenda datës 31 dhjetor 2020, kanë të drejtë të zgjedhin për të përfituar nga skema e mbështetjes, sipas kontratës për diferencë, ose një tarifë Feed-In e llogaritur nga ERE, por me një çmim jo më të vogël se viti 2016. Gjithashtu, deri në krijimin e tregut të balancimit dhe përpara fundit të 2022, prodhuesit ekzistues me përparësi janë të përjashtuar nga detyrimet e balancimit.
Neni 8 dhe VKM 349	Ankandet e zhvilluara, nepermjet te cilave eshte perfituar mbeshtetja feed in me te drejte konvertimi ne CfD.
Udhëzimi i Ministrit neni 22	Është miratuar Udhëzimi i Ministrit për certifikatën e pranimit të veprës

Gjithashtu, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 519 për Modelin e Tregut, parashikon transformimin e kontratave ekzistuese në ato KpD duke lejuar prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike të jenë përgjegjës dhe palë në balancim.

Numri më i madh i përfituesve të tarifës “Feed In” janë hidrocentralet tashmë të ndërtuara (duke përjashtuar disa me fuqi të mëdha) ose ato impiante të cilat kanë një Certifikatë të Pranimit të Veprës përpara datës 31 Dhjetor 2020. Lista e plotë është e publikuar në faqen e ERE.

Figura 1. Paraqet skemat ekzistuese për energjinë e rinovueshme.




Tabela më poshtë përmbledh volumet e secilës skemë mbështetëse. Pjesa më e madhe e skemave mbështetëse jepet nëpërmjet tarifës Feed-In për prodhuesit ekzistues me përparësi.

Skema e Mbështetjes	Volumet
Ankandet dhe KpD	Deri në momentin e hartimit të këtij dokumenti nuk ka ankand për energjinë e erës dhe energjisë hidrike. Për energjinë fotovoltaike janë zhvilluar 2 ankande: 1) Karavasta: gjithsej 140 MWp (70 MW me skemë mbështetëse) e nënshkruar në vitin 2020. Ndërtimi pritet të fillojë së shpejti. 2) Spitalla: gjithsej 100 MWp (70 MWp me skemë mbështetëse KpD), është hapur procedura konkurruese, parashikohet të nënshkruhet kontrata në vitin 2021. Duhet theksuar fakti se rezultatet e ankandit janë ende sipas skemës FIT pasi mekanizmi KpD nuk është Akoma në fuqi. Sapo të krijohet një model i KpD, të gjithë fituesit e ankandeve do të marrin një skemë mbështetëse me anë të KpD.
Tarifa "Feed In" për energjinë eolike dhe fotovoltaike	Deri më sot nuk është ndërtuar asnjë projekt eolik. Lidhur me teknologjinë fotovoltaike, deri në fund të vitit 2019, janë ndërtuar 8 impiante me një kapacitet të kombinuar prej 16 MW dhe një gjenerim vjetor prej 22,196 MWh ¹ . Tarifa Feed In është 100 EUR / MWh, e cila rezulton në një faturë financiare prej 2.22 Milion Euro.
Skema e matjes neto të energjisë	Ekzistojnë projekte në shkallë të vogël (kryesisht PV). Një inventar duhet të kryhet në mënyrë që të paraqitet një pamje e plotë mbi zhvillimin e kësaj skeme mbështetëse.
Tarifa Feed In për hidrocentralet	Në fund të vitit 2019, 128 prodhues (në 182 HECV) kanë prodhuar 1,463,274 MWh me një kapacitet të instaluar total prej 560 MW ² për vitin 2019. Me një tarifë prej 8.4582 lekë / kWh, fatura totale financiare ishte 97 Milion Euro ³ .

1.2. Qëllimi i transformimit të tarifës FIT në KpD

Objektivat e transformimit të FIT në CFD janë si më poshtë:

- Rrit likuiditetin në ALPEX duke vendosur detyrimin për të shitur energjinë nga burimet e rinovueshme në ALPEX, në mënyrë direkt për përfituesit e KpD dhe indirekte përmes Operatorit të Energjive të Rinovueshme për përfituesit e FIT.
- Vendos përgjegjësinë për balancim ndaj përfituesve të KpD dhe/ose FIT.
- Zvogëlon ndikimin e skemës FIT për blerësin aktual të prodhimit, OSHEE / FTL.

Sipas përcaktimeve në ligjin 7/2017, të gjitha ankandet për kapacitete të reja të rinovueshme do të mbështeten nëpërmjet KpD. Gjithashtu, përfituesit aktualë të FIT mund të kalojnë në mbështetjen sipas KpD me një çmim të caktuar të barabartë me tarifën FIT.

Prodhuesit e vegjël me përparësi do të vazhdojnë të mbështeten nëpërmjet tarifës “Feed In”. Skema FIT mbetet e ngjashme për ta. OER do të ishte blerësi i vetëm i energjisë së tyre dhe do ta shesë atë në ALPEX duke dhënë pjesën e diferencës mes Çmimit të Ditës në Avancë (çmimit referent) dhe tarifës FIT.

2. Ndryshimet më të rëndësishme të skemës mbështetëse

2.1. Mekanizmi i parashikuar për KpD

Ky kapitull paraqet mekanizmin e mbështetjes nëpërmjet KpD sipas draftit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për Themelimin e operatorit të energjisë së rinovueshme.

Karakteristikat kryesore të kuadrit mbështetës nëpërmjet KpD në Shqipëri janë:

- Prodhuesit me përparësi duhet të tregtojnë energjinë e tyre në tregun e ditës në avancë (ALPEX) për të përfituar nga skema e mbështetjes sipas KpD. Prodhuesit me përparësi do t'u nënshtrohen të njëjtave rregulla si çdo pjesëmarrës tjetër të tregut në ALPEX. Kjo përfshin edhe përgjegjësinë e balancimit.
- Operatori i Energjisë së Rinovueshme (OER) paguan diferencën midis çmimit të caktuar (qoftë kjo FIT apo KpD) dhe çmimit të referencës për prodhuesit me përparësi. Në rast se diferenca është negative, prodhuesit me përparësi do të paguajnë diferencën tek OER.
- Prodhuesit ekzistues me përparësi që përfitojnë nga skema e mbështetjes FIT mund të zgjedhin për të kaluar nga skema FIT në KpD. Çmimi i caktuar do të mbetet sipas tarifës “Feed In”.
- Ankandet do të përcaktojnë çmimin e caktuar për prodhuesit e rinj me përparësi.
- Një tarifë e vazhdueshme e quajtur Detyrim i Energjisë së Rinovueshme dhe që u ngarkohet të gjithë konsumatorëve të energjisë elektrike përmes furnizuesve të tyre, do të shërbejë për të financuar OER. Metodologjia dhe llogaritja e saktë do të vendoset në muajt e ardhshëm.

2.2. Diferencat midis FIT dhe KpD për prodhuesit me përparësi

Tabela më poshtë paraqet diferencat kryesore ndërmjet FIT dhe CfD

Kategoria	Tarifa Feed-in	Kontrata për Diferencë
Të ardhurat financiare për prodhuesit me përparësi	Një entitet i vetëm merr gjithë energjinë e gjeneruar pa kufizime.	Dy burime të ardhurave: shitja e energjisë elektrike në ALPEX dhe mbështetja nga OER.
Marrëveshjet e shitjes së energjisë	Nuk nevojitet asnjë përpjekje për të shitur energjinë e prodhuar, pasi një entitet i vetëm është përgjegjës për të marrë të gjithë energjinë e gjeneruar.	Prodhuesit me përparësi duhet të sigurohen që të shesin energjinë elektrike në mënyrë efektive në ALPEX. Megjithatë, në praktikë, Prodhuesit me përparësi janë pothuajse të garantuar që energjia e tyre do të merret për shkak të kostos së tyre marxhinale të prodhimit e cila është shumë të ulët.

1- Nga raporti vjetor i ERE për vitin 2019

2- Faktori i kapacitetit është marrë rreth 30% për vitin 2019

3- Kursi i këmbimit ishte 127.575 ALL/EUR

Përgjegjësia për balancim	Siç përcaktohet në ligjin e energjisë së rinovueshme të vitit 2017 (neni 22): deri në krijimin e tregut të balancimit, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2022, prodhuesit ekzistues me përparësi nuk do të jenë përgjegjës për kostot e disbalancave të shkaktuara.	Prodhuesit me përparësi janë përgjegjës për disbalancat dhe si rrjedhojë ata duhet të parashikojnë prodhimin e tyre dhe do të jenë përgjegjës financiarisht për disbalancat e shkaktuara.
----------------------------------	---	---

Dy figurat e mëposhtme paraqesin ndërveprimet midis palëve të ndryshme të interesit në lidhje me skemat e mbështetjes nëpërmjet KpD dhe FIT. Flukset fizike të energjisë paraqiten me blu dhe flukset financiare me jeshile.




Figura 2. Marrëdhënia midis palëve të interesit në KpD




Figura 3. Marrëdhënia midis palëve të interesit në FiT

2.3. Funksionimi i Operatorit të Energjive të Rinovueshme

Operatori i Energjisë së Rinovueshme do të menaxhojë njëkohësisht skemat e mbështetjes me anë të KpD dhe FiT. Konkretisht, rolet e tij janë si më poshtë:

- **Në lidhje me KpD-në** : OER do të jetë vetëm një ndërmjetës financiar. Ai nuk do të marrë pjesë në tregtinë e energjisë elektrike. Roli i tij do të jetë vetëm mbledhja e të dhënave (prodhimi i energjisë së secilit prodhues dhe çmimi i tregut), si dhe llogaritja e transfertave financiare dhe mbajtja e llogarive.
- **Në lidhje me FiT**: OER do të blejë të gjithë energjinë e prodhuar nga përfituesit e FiT. Ai më pas do të shesë të gjithë këtë produkt në ALPEX dhe do të jetë përgjegjës për imbalancet e shkaktuara në perputhje me parashikimet e ligjit 7/2017 lidhur me imbalancat. OER do të mbledhë të gjitha të dhënat e nevojshme për të parashikuar me saktësi nivelin e gjenerimit për të minimizuar imbalancat.

Meqenëse prodhuesit ekzistues me përparësi kanë oporunitetin të zgjedhin të qëndrojnë me skemën mbështetëse sipas FiT⁴ pasi aktualisht skema FiT është shumë më e madhe se KpD, të paktën në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Prandaj, OER do të bëhet operatori mbizotërues i tregut në ALPEX⁵.

REO, sipas ligjit 7/2017 do të financohet nga Detyrim i Energjisë së Rinovueshme që do t'u vendoset të gjithë konsumatorëve bazuar në një tarifë fikse për kWh të konsumuar. Furnizuesve do t'u kërkohet që t'ia ngarkojnë këtë detyrim klientëve të tyre përmes faturave të tyre të energjisë elektrike dhe të transferojnë shumën e mbledhur tek OER. Ky rregullim nuk pritet të ketë impakt në tarifen e konsumatorëve fundorë.

2.4. Masat tranzitore

Skema e mbështetjes sipas KpD-së nuk mund të funksionojë nëse ALPEX nuk do të jetë funksional. Si pasojë, skema e mbështetjes sipas KpD-së do të mund të jetë funksionale vetëm pas nisjes së punës të ALPEX, e cila planifikohet gjatë vitit 2021.

Përveç kësaj, Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) do të ndërmarrë kontratat ekzistuese të FIT derisa OER të financohet dhe të funksionojë.

3. Vlerësimi i kostos së skemave mbështetëse për OER

3.1. Hyrje dhe përkufizime

Kostoja e skemave të mbështetjes mund të llogaritet si më poshtë:

- **Në lidhje me KpD:** kostoja është shuma totale e transferuar nga Operatori i Energjisë së Rinovueshme (OER) tek furnizuesit.
- **Në lidhje me FIT:** kostoja është diferenca midis çmimit të paguar nga entiteti përgjegjës për të blerë energji elektrike (sot FSHU dhe FTL) dhe të ardhurave të marra nga shitja e energjisë elektrike në treg.

3.2. Llogaritja e kostos për një prodhues i cili mbështetet nëpërmjet FIT dhe KpD

Llogaritja e kostos paraqitet në aneksin 1. Kostoja për skemën FIT në përgjithësi do të ishte pak më e lartë se kostoja për CfD (në rastin kur çmimi i caktuar është tarifa FIT). Diferenca vjen si pasojë e kostove e transaksioneve, të cilat përfshijnë kosto të disbalancave (sipas ligjit mbi energjinë e rinovueshme 7/2017) dhe tarifatat e nevojshme për të operuar në ALPEX.

3.3. Kostoja totale e skemës

Në vijim të përshkrimit më sipër, parashikohet që të gjithë prodhuesit ekzistues me përparësi të mbeten në skemën FIT. Si rrjedhojë, kostoja totale për OER është shuma e të gjitha pagesave sipas FIT e zbritur me të ardhurat nga tregu, e cila shprehet si shitja e energjisë elektrike minus kostot e transaksioneve (p.sh. kostot e disbalancave dhe tarifatat për ALPEX). Për vitin 2019, siç tregohet në tabelën e faqes 2, kishte përkatësisht 1,463,274 MWh dhe 22,196 MWh gjenerim hidrik dhe fotovoltaik sipas skemës FIT. Me çmimet e aplikuar në vitin 2019, kjo shumë përfaqëson rreth 99.23 Milion Euro.

Të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike në treg përllogariten duke marrë një çmim mesatar të tregut prej 50 € për MWh⁶, ose në total 74.27 Milion Euro. Duke konsideruar që kostot e transaksioneve (disbalancat dhe tarifatat e ALPEX) do të ishin 5% e totalit të kësaj sasive të shitur, përllogaritet që skema e mbështetjes për REO do të ishte 28.68 Euro.

Detyrimi i Energjisë së Rinovueshme, i cili paraqitet si një tarifë fikse e aplikuar ndaj të gjithë konsumatorëve, mund të llogaritet duke marrë parasysh koston e skemës së mbështetjes⁷ dhe totalin e energjisë elektrike të faturuar në 2019, e cila është 5,052,259 MWh. Tarifa që rezulton është 5.85 € për MWh.

4- Pa incentivë prodhuesit me përparësi preferojnë nga ana financiare të mbajnë skemën FIT

5- Për shkak se KESH do të vazhdojë të jetë i detyruar për Obligimin e Shërbimit Publik, OER do të tregtonte pjesën më të madhe të energjisë elektrike në Shqipëri.

Kjo tarifë varet kryesisht nga çmimi i tregut dhe nga kushtet hidrologjike⁸. Për më tepër, projekti Voltalia por edhe rezultatet e ankandeve të ardhshme, do të ulnin koston totale të fondit nëse çmimi i caktuar është mesatarisht më i ulët se çmimi i tregut. Një vlerësim më i hollësishëm i Detyrimit të Energjisë së Rinovueshme do të duhej të kryhet siç gjithashtu paraqitet në kapitullin më poshtë për masat aktuale.

4. Masat Aktuale

Masat	Përshkrimi	Afati Kohor	Ndryshimet ligjore të nevojshme
Krijimi i ALPEX	Tregu i përbashkët i energjisë midis Shqipërisë dhe Kosovës është parashikuar të fillojë gjatë vitit 2021. Aktualisht, po zhvillohet një tender për të prokuruar një ofrues shërbimi për të operuar ALPEX.	Tremujori i 2 - 2021	Nuk ka nevojë për ndryshime ligjore.
Krijimi i OER	Një parakusht për fillimin e funksionimit të skemës së KpD-së është krijimi i Operatorit të Energjisë së Rinovueshme (OER).	Fillon në 2021	Mund të nevojitet ndryshimi i VKM 244 .
Përlllogaritja e detyrimit të energjive të rinovueshme	MIE do të vlerësojë Detyrimin për Energjinë e Rinovueshme për tre vitet e para të funksionimit të fondit.	Janar 2021	Nuk ka nevojë për ndryshime ligjore.
Hartimi i modelit të KpD-së	MIE do të përfundojë hartimin e një kontrate model për skemën e KpD-së.	Mars 2021	Nuk ka nevojë për ndryshime ligjore.
Analizë sasiore për ndikimin në ALPEX dhe përlllogaritja e Detyrimit të Energjive të Rinovueshme.	Në mënyrë që të vlerësohen shtë shumat financiare të cilat do të nevojiteshin nga OER, është e nevojshme të bëhet një analizë sasiore e nisjes së ALPEX. Kompania Artelys, në pozicionin e konsulentëve të financuar nga AfD, janë duke bërë një analizë të tregut shqiptar, i cili do të japë disa të dhëna për ALPEX-in në të ardhmen. Ky ushtrim do të ofronte një bazë për të llogaritur shumën e Detyrimit të Energjisë së Rinovueshme të nevojshme për të financuar tërësisht REO.	Fillon në 2021	Nuk ka nevojë për ndryshime ligjore.

5. Skëmat e mbështetjes që rezultojnë pas implementimit të strategjisë

Pas zbatimit të kësaj strategjie, mbështetja për prodhimin e energjisë së rinovueshme do të përbëhej nga tre kolonat⁹ më poshtë të cilat plotësojnë njëra tjetrën. Objektivi i tyre është të përshpejtojnë tranzicionin e energjisë dhe të arrijnë objektivat e dakorduara të Qeverisë së Shqipërisë.

6-Ky supozim është i vështirë për tu vlerësuar, përderisa ALPEX nuk është Akoma në funksion. Qëndron mundësia që për shkak të koston marxhinale të ulët në tregun e energjisë, çmimi mesatar të jetë më i ulët.

7- 3% janë shtuar tek kostot operationale për menaxhimin e fondit

8- Viti 2019 ka qenë vit veçanërisht i thatë.

⁹ Kjo është e vlefshme për kapacitetet e reja të rinovueshme

Kolona	Mënyra e funksionimit	Përparësitë
Net Metering deri në 500kW për të gjithë konsumatorët	Çdo konsumator i energjisë elektrike mund të gjenerojë energji elektrike të rinovueshme për qëllimet e tija. Në këtë rast do të zhvillohet një skemë e faturimit neto.	<ul style="list-style-type: none"> • Siguron pjesëmarrje të individëve dhe sipërmarrjeve të vogla në tranzicionin drejt energjive të rinovueshme. • I thjeshtë për tu zbatuar. Nuk nevojitet përfshirje intensive e ministrisë ose e operatorëve të energjisë elektrike.
Tarifa Feed In për prodhuesit e vegjël	Prodhuesit e vegjël me përparësi do të përfitonin nga një skemë e ngjashme FIT me OER në pozicionin e blerësit të energjisë. Përkufizimi i prodhuesve të vegjël do të ishte në përputhje me udhëzimet dhe direktivat e BE-së.	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështet prodhuesit e vegjël pa i vendosur atyre një barrë administrative.
Kontrata për diferencë nëpërmjet Ankandëve	Ministria do të organizojë ankande për kapacitete të reja të rinovueshme. Specifikimet e këtyre ankandëve do të varen nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë diversifikimin optimal të burimeve të energjisë, aftësinë e rrjetit për të përthithur energjinë. Ofertuesit do të konkurojnë në këto ankande dhe atyre të cilëve do të rezultojnë të suksesshëm do t'u jepet një skemë mbështetëse nëpërmjet KpD.	<ul style="list-style-type: none"> • Aftësia e ministrisë për të udhëhequr shtimin e kapaciteteve të reja të energjive të rinovueshme. • Mekanizëm i bazuar në konkureshmëri i cili prodhon në një mbështetje më pak të kushtueshme për energjitë e rinovueshme. • Konkureshmëri e drejtë dhe transparente.

Aneksi 1: Përlllogaritja e kostove të FiT dhe KpD për një prodhues

Përkufizimet e variablave:

π_m : Çmimi i tregut – çmimi i përftuar në ALPEX [€/MWh]

$\pi_s = \pi_{FIT}$: Çmimi i caktuar ose çmimi FiT (të cilat konsiderohen të barabarta) [€/MWh]

G_F : Parashikimi i prodhimit, si dhe prodhimi i shitur në ALPEX [MWh]

G_R : Prodhimi Real, Prodhimi i Matur (në kohë reale) [MWh]

I_{mb} : Kostot e disbalancave, si diferenca midis prodhimit të parashikuar dhe atij real [€/MWh]

Për skemën FiT, kostoja për një orë do të llogaritet si më poshtë:

$$C_{FIT} = \pi_s * G_R - tw \text{ ardhurat nga tregu}$$

$$C_{FIT} = \pi_s * G_R - (G_F * \pi_m - Imb)$$

Si pasojë, kosto totale e skemës FiT për një përftues llogaritet si më poshtë:

$$C_{FIT}^{tot} = \sum_{i=1}^{8760} \pi_s * G_{R,i} - (G_{F,i} * \pi_{m,i} - Imb_i)$$

Për skemën e KpD, kosto për çdo orë përlllogaritet si më poshtë:

$$C_{CfD} = G_R * (\pi_s - \pi_m)$$

Si pasojë, diferenca ndërmjet FiT dhe KpD shprehet si më poshtë:

$$\Delta = C_{FIT} - C_{CfD} = \pi_m * (G_R - G_F) + Imb$$

Në rast se prodhimi real është i barabartë me prodhimin e parashikuar, nuk do të ketë një diferencë në kosto midis FiT dhe KpD. Në rast se ka një diferencë ndërmjet prodhimit të parashikuar dhe atij të prodhuar, skema FiT do të jetë më e kushtueshme se KpD.